


RELACION

Banesa Muhamet Fico

Monument I Kategorisë së parë, Gjirokastrë, Kodi


Lagjja "Palorto"



1. Hyrje	3
2. Përshkrimi i kompozimit Arkitektonik	4
3. Muratura	4
4. Përshkrimi i gjendjes ekzistuese.....	5
5. Konkluzione	5

1. Hyrje

Ky relacion hartohet nga DRKK – Gjirokastrë. Pas investigimit të bërë nga stafi teknik rezultoi se: **“Banesa FICO ”** e ndodhur në lagjen “Palorto ”, Monument kulture, Kategoria e parë, shpallur më dt. 10.06.1973, me vendim nr. 1886, nga Ministria e Arsimit dhe Kulturës, ndodhet brenda zonës së mbrojtur, Gjirokastrë. Pronësia e objektit është private, me pronar Lule Fico dhe Marjeta Fico.



POZICIONIMI

ORTOFOTO



2. Përshkrimi i kompozimit arkitektonik

Kjo ndërtesë paraqet interes të vecantë për faktin se duke qënë ndërtuar në vitin 1902, jep një ide të qartë të zhvillimit të banesës gjirokastrite deri në fundin e shekullit të kaluar. Në planin kompozicional banesa përsërit variantin e thjeshtë me dy krahë, duke i shtuar këtij një bllok në krahun e djathtë. Në katin përdhe janë vendosur nëndiavani, katoi, stera dhe qilari i zahiresë, në katin e parë dy ambiente banimi, hapësirë qendrore ndërlihdhëse, si dhe një ambient gatimi. Kati i dytë përsërit të njëjtën skemë. Mbi pjesë qendrore ndërlihdhëse, të katit të dytë është ndërtuar një ambient, që del në formë manserne, rast ky shumë i rrallë në Gjirokastrë. Ndërsa kompozimi i banesës në përgjithësi përsërit formën tradicionale, trajtimi i brendisë dhe sidomos i pamjes së jashtme të banesës tregon qartë për një shkëputje të ndjeshme nga format e vjetra. Brëndësia ka një përpunim mjaft të thjeshtë, komplekset musandër – dhipato nuk ndërtohen më, por kanë mbetur si një rundiment që shfaqet në trajtimin formal të perdes fundore të odave të katit të dytë. Një përkujdesje e vecantë i kushtohet pamjes kryesore ku shquajnë si volume dy ballet e odave të katit të dytë në formë erkeri, si dhe ne mansard që thekson volumin qendror të ndërtimit.

Dekoracionet e shumta të pamjes kryesore në dru dormat e harkuara të mbështetëseve të erkerëve, i japin asaj tiparet e një arkitekture ku ndjehen influenca të barokut të vonë. Me interes të vecantë në këtë banesë, është ekzistenca e një dhipatoje me shtrirje të gjërë mbi volumin ndërlihdhës, prapa odës së djathtë në katin e dytë, i cili vazhdon edhe ambientin e improvizuar ndërmjet kësaj dhome dhe atij të gatimit. Kjo zgjidhje bën shfrytëzimin e lartësisë shumë të madhe në këto ambiente të banuara duke vazhduar traditën e njohur në këtë drejtim. Kjo ndërtesë është ndërtuar pranë një banese më të vjetër, nga e njëjta vëllazëri. Nevoja për të siguruar ndërlihdhjen e drejtëpërdrejtë dhe lehtësisht ndërmjet dy banesave, ka kushtëzuar ndërtimin e një qemeri cilindrik në nivelin e dyshemesë së katit të dytë, i cili siguron lidhjen e të dy banesave, pa cënuar një rrugicë nën të.

3. Muratura

Muret e jashtme janë të ndërtuara me gurë me llaç gëlqere. Balli i banesës është me çatma në të cilin dallojmë daljen e dy herkerave të mbështetura mbi tre gjunjë.

Çatia është me konstruksion druri dhe e mbuluar me rasa guri. Nga ana e pasme, muri rrethues është në gjithë lartësinë e tij dhe në pjesën e dhipatosë (pjesa e ngritur që ngrihet pingul me çatinë kryesore të ndërtesës) me gur, ndërsa dhipato, nga pjesa anësore është mbyllur me çatma. Lidhja e murit rrethues me catmanë është e dobët dhe nga kjo mendojmë se është shkaktuar edhe rrëzimi i murit.

Teknika e muraturës në pjesën rrethuese të jashtme nga pas ndërtesës, është me teknikën gur gërqeror të lidhura me llaç çimento dhe me breza druri horizontalë. Pjesa e brendshme dhe e jashtme e muraturës nuk lidhen me njëra-tjetrën, përveç pjesëve të drurit që janë prej lisi, me përmasa 5x7 cm dhe lidhen midis tyre me elementë pingul, të po këtyre përmasave.


4. Përshkrimi i gjendjes ekzistuese

Në vitin 2012, në këtë objekt, nga DRKK Gjirokastrë, është bërë një ndërhyrje, duke restauruar çatinë, fasadën kryesore, muret me çatma dhe mjediset e brendshme të ndërtesës. Pjesa e mureve rrethues të jashtëm, nga ana e pasme e ndërtesës, paraqet një formë të kundërt të fasadës. Kati përdhe dhe kati I parë janë në nivelin e tokës dhe ndahen nga toka nga një kanal shumë I ngushtë dhe pjesërisht I mbushur me mbeturina dhe nuk dihet deri në çfarë thellësie është ky kanal. Mbi nivelin e tokës ndodhet kati I dytë dhe pjesa e ngritur e dhipatosë mbi katin e dytë. Ky mur ka ngelur jashtë vëmendjes së investimit të bërë. Si rezultat I lagështisë që ka ardhur nga kreu I muraturës dhe nga pjesët anësore të dhipatosë, brezat horizontalë të drurit janë kalbur dhe ka ndodhur shpëputja e brezave të drurit, duke shkaktuar shpërbërjen e tyre dhe ndarjen e muraturës në dy faqe, duke rënë faqja e jashtme e saj, nga kati I tretë dhe një pjesë e muraturës së katit të dytë.


5. Konkluzione

Sic shihet nga fasadat pajantimi I gjithë objekti është bërë, por në momentin e ndërhyrjes ato duhet të forcohen. Pasi të forcohen pajantimet do të fillojë prishja e murit të mbetur dhe të ruajtur nga pajantimi. Pasi të pastrohet nga muri I demtuar do të fillojë pastrimi I kanalit pas shtepisë I cili tani është I mbushur me balte. Pas pastrimit, do të duket se sa është demtimi nga ana e jashtme e murit mbajtes. Pasi të gjykohet se sa I demtuar është muri do të fillojë edhe rindërtimi I tij si në projekt duke pasur parasysh zgjatimin e brezit të drurit cdo 80 cm me lende pishe të stazhionuar. Do të fiksohen mbi murin mbajtes tabanet e nderkateve, shkallet e drurit dhe do të bëhet një pjesë e catise në qendër dhe restaurimi I spërtheve të demtuar.


PLANI I KATIT PËRDHE




PLANI I KATIT TË DYTË



PLANI I KATIT TË TRETË



PLANI I KATIT TË KATËRT/PLANI I CATISE



PRERJE A-A




Foto e murit të rrëzuar ne pjesen e pasme te objektit










Foto e murit të rrëzuar ne pjesen e pasme te objektit





Brezat e drurit cdo 80 cm. Pajantimi I murit nga ana e jashtme.



Pajantime te dyshemese dhe catise se objektit nga ana e brendeshme te bera nga DRTK Gjirokaster per te ruajtur objektin.



Nderhyrje te brendeshme nga DRTK Gjirokaster per mbajten e murit

Vasil
Polo

Digitally signed by Vasil
Polo
Date: 2023.04.19
10:28:31 +02'00'

Konceptoi: Ing. Vasil Polo

